

EQREM ÇABEJ

STUDIME RRETH ETIMOLOGJISË SË GJUHËS SHQIPE XXV

V.

vā m., n., f. «vend i cekët në një lumë për të dalë matanë». Fjalë me burim të diskutuar. G. Meyeri më parë (AS I 68) gjente aty një fjalë vendi, të afër mbase me lat. *vadum* «va», po më vonë (Fj. et. 461) e binte të ardhur prej kësaj fjale latine; ashtu dhe Meyer-Lübke Gr Gr I² 1052 e MRIW I 28, Pušcariu EW 1849, Weigandi 96, Philippide II 657, Tagliavini 285v., Pokorny I 1109, Cimochowski LP II 243. Një fjalë vendi të shqipes sheh aty përkundrazi Spitzeri MRIW I 332, duke e nxjerrë *vā*-në nga një bazë fem. **vadhā* e duke e krahasuar me lat. *vadum*, nord. e vj. *vað* «va», ags. *waed* «ujë», gjerm. e lartë e vj. *wat* «bie në va» etj. Kështu edhe Jokli (Albanisch 135; IF 36, 105 e 137; 49, 292, Arch. Rom. XXIV f. 40 e botimit të veçantë), ky dijetar duke vënë në dukje ekzistencën e disa fjalëve që sipas tij kanë një lidhje apofonie me *vā*-në, si *vuaj*, e *vueme* «va» e ndonjë tjetër; etimologjikisht e afron gjithashtu me lat. *vado* «shkoj, vete, eci» *vadum* «va», gjerm. e lartë e vj. *wat*, nord. e vj. *vað* «va» etj. Nga një neutër indoeur. **uadhom* e spiegon *vā*-në Manni Lg. 28,33.

Fjalë e mbarë gjuhës. Del sëpari te Budi (RR 332), *ōse mbë qish të shtrintë e të mërekulluoshim vā kanë me rām*, ku nuk kuptohet gjinia. Neutër te Bogdani (I, 80, 8), *ndjerë të mos shkonte vātë të Shenjtit Pa-gëzim* «se prima non passa il Tragetto del S. Battesimo». Në vështrimin e parë burimi i vendit dhe burimi latin i kësaj fjale paraqiten barabar të mundura, po një vështrim i çështjes më për së afërmi tregon se kemi të bëjmë me një fjalë vendi. Edhe duke lënë mënjanë çështjen — jo të sqaruar mirë — të afërive të brendshme të fjalës, me *vete*, me *vuaj vuej* dhe *e vueme* etj., kriteri fonetik flet kundra një burimi latin. Me rënien e hershme të mbaresave me zanore të shkurtër në gjuhën shqipe, lat. *vadum* do të kish dhënë këtu një **vadh*, jo *vā*. Zhdukja e konsonantit të zëshëm tregon se ky lashtërisht ka qenë në pozicion ndërzanor dhe se zanorja që e ndiqte nuk ishte e shkurtër që të binte që heret, po e gjatë. Kështu si bazë e fjalës do menduar një **vadhā*, jo **vadhōm* si mendon Manni. Nuk vjen në vështrim si bazë një shumës latin *vada* që rindërton Siadbei (Mél. ling. publiés à l'occ. du VIII^e Congr. Int. des Ling. à Oslo 1957, f. 69), sepse nuk ka njëjës të shqipes prej shumësesh latine. Baza **vadhā* ndërkaq nuk do marrë (me Spitzerin e Joklin) si një femërore, po si një neutër shumës, i cili reflektohet me neutrin *vā* që ruhet te Bogdani. Dihet (sh. Pedersenin KZ 34, 285v.) që neutrat e shqipes rrjedhin prej neutrash indoeuropianë shumës më *-ā*. — Sh. edhe *vanë*, *vp vani*, *rrëfanë*, *rruvā*.

vag-a f. «kandar», në Nikaj-Mertur (kumtim i E. Lafes); *vagir* m. «peshojë e vogël», mbetur pa spjegim etimologjik te Weigandi 96. Manni këtë e jep me trajtën *vagúr* «bar, swing-bar», po pa të drejtë vë në dyshim trajtën e Weigandit (*vaguri* i *zjarmit* po te Manni do të jetë një shndrim i *vargu* i *zjarmit* «vargoi i zjarmit»). Edhe Tasi 114 jep *vagir* «peshojë». Vjen nga gjerm. *Wage*, gjerm. e lartë e vj. *wâga* «peshojë», nëpërmes të serbokr. *vaga* «terezi, peshojë» *vagati* «me peshue». Një nga ato fjalë gjermane që kanë hyrë në shqipen nëpërmes të serbokroatishtes, si *fërtele*, *mashtërk* etj.

vagëlló «hap e mbyll sytë, vështroj me sy për gjysmë të mbyllur; nuk shoh mirë nga sytë»; *kandilja vagëllon* «po venitet, është më të fikur»; *vagullon* «sapo nis të gdhihet». Nga kjo fjalë G. Meyeri 4 jep (pas Kristoforidhit Apostujt 5, 21) *mbë të vagëlluarë* «ndaj të gdhirë» dhe e lidh përbrenda shqipes me *agón*. Manni (Lg 28, 38) *vagull* «i errët, i dobët» e krahason me gr. *ἀχλύς* «mjegull, errësirë» isl. e vj. *vagl(-eygr)* angl. *wall(-eyed)*, baza indoeuropiane sipas tij një **uaghlos*, -us.

Fjalë e mbarë gjuhës, po me trajta e kuptime të shumëllojta. Forma bazë gjan të jetë *vagull*. Andej rrjedhin foljet *vagulloj*, *vagëlloj*, *vagëllon* etj. që u dhanë më sipër, të cilat për një pjesë gjinden te Tasja. Me *vagulloj* lidhet më tej *zvugullon* (shkruar *svugullon*) «zbardh drita» po *zvugullojnë malet* «po agon, po zbardh drita» që jep Kristoforidhi 367 për të folët e Kavajës e që Manni 465 pa të drejtë e vë në dyshim, duke e emenduar — me rezervë — në *vagulloj*; *zvugulloj* nga *vagulloj* me prefiks *z-* intensiv (ky mbase dhe me një ndikim të sinonimit *zbardh*) e me ndrim të *a-së* paratheksore në *u* (mundet nëpër një *ë*), ashtu si te *zambak*: *zumbak*, mbase edhe me një asimilim ndaj *u-së* së rrokjes së dytë të fjalës. Një tjetër formë e *vagulloj*, me epentezë «popullore» të një *-n-je*, është *vanguilloj sytë* «zvogëloj, picërroj sytë» e Kristoforidhit, me epentezë edhe të një *r-je* *vranguilloj sytë*, e cila si e tillë është sekundare ndaj *vanguilloj*, jo primare, si mendon Jokli Studien 80. — Sidomos nga *vagulloj* «sapo nis të gdhihet» e nga *mbë të vagëlluarë* «ndaj të gdhirë» shihet se kuptimi i mirëfilltë i fjalës është ai i zbardhëllimit të parë të dritës, i agimit. Prandaj *vagull* lidhet me *agull*, në *më janë bâ sytë aguj* «më janë veshur sytë», *vagulloj* me *agullohem*, *më janë agullue sytë* «më janë terratisë», e *mbë të vagëlluarë* me *në t'agulluemit të dritës* e *agullim* «agim». Si u tha dhe më lart te *agon*, trajta *agull* është një zgjerim me *-ull* i *ag.-ut* në *me vû ag sytë*, *agu* i *synit*. Ashtu edhe *vagull* *vagulloj* *vagëlloj*, me gjithë zhvillimet e mëtejme të tyre (*vanguilloj*, *vranguilloj*, *zvugulloj*), nuk janë gjë tjetër veçse formime të atyre së parave me prefiks *v(ë)-*; për çfaqjen e këtij formanti në folje sh. Xhuvani-Çabej BSS 4 (1956) 101. Te *vagull*, *vagëlloj* etj. kemi të bëjmë kështu me një fjalë relativisht të re e të zhvillimit të brendshëm të gjuhës. Në këto rrethana nuk ka vend për një krahasim të pandërmjemë e në shkallë indoeuropiane me gr. *ἀχλύς* o me fjalë të tjera, si isl. e vj. *vagl(-eygr)* e angl. *wall(-eyed)*. Puna e burimit të *vagull* *vagëlloj* lidhet në analizë të fundit me atë të *ag* *agon*, me të cilën e bashkoi — në thelb me të drejtë — G. Meyeri.

vagjëli f. «ushqim i mirë, kujdes, kurë, mbajë», *i sëmuri do vagjëli* *sa të shëndoshet*, *pleqëria do vagjëli*. Fjalë dialektore e toskërishtes, që mungon te G. Meyeri. E ka Tasi për gr. *διαίτα* «pehëz, diet» poashtu Kordignano për «dieta», Tasja si «dëfrim, gëzim i vogël; të kënaqur të vogël si me thënë të rrojtur, të shkuar, të ngrënë mirë»; edhe folja *vagji-*

leps «vështroj, kujdesem për», e *ke vagjilepsur vetë* (*lopën*). Nga gr. e re βαΐλας «shërbyes» βαΐλίτζω «shërbej» βαΐλεύω «përkëdhel fëmijët», kjo prej lat. *baiulus* «hamall», në greqishten bizantine. βαΐουλος, sh. për fjalën greke G. Meyerin NS III 12v., Trandafilidhin 38. Pra kemi të bëjmë me një nga ato fjalë latine që kanë hyrë në shqipen me anë të greqishtes, sh. për këto Revue de Ling. VII 1 184v. Prej greqishtes rrjedh dhe bullg. *vagljam vagiulja* «vështroj foshnjen» *vagilar* «ai që vështron, që ka kujdes një foshnje», të cilën Błlg. et. rečnik 111 pa të drejtë e spiegon nga rum. *veghia* «ruaj» prej lat. *vigilare*. — Sh. dhe *bajlóz*.

vajë f. «mëndeshë, tajë». Fjalë dialektore e toskërishtes, mungon te G. Meyeri. E ka edhe Boçari 14. Nga gr. e re (o e mesme) βάγια βαιά, e cila rrjedh në thelb prej lat. *baiulus*, sh. për fjalën greke G. Meyerin NS III 13. Një nga ato fjalë që prej latinishtes kanë depërtuar në shqipen nëpërmes të greqishtes, si *vagjëli*. Fjala greke ka kaluar dhe në bullgarishten, Mladenov 59, Błlg. etim. rečnik 124.

Vajkál m. «pjesa perëndimore e luginës së Bulqizës në Dibër, nëpër të cilën kalohet për të dalë në Mat; një lagje e Bulqizës». Te Barleci (De vita moribus ac rebus precipue adversus Turcas gestis, Georgii Castrioti, clarissimi Epirotarum principis, 1537) *Valchal*; sh. edhe H. Cekën Bul. i Inst. të Shk. III (1952) 31. Përmendet shpeshherë, si *Valkal*, dhe te Kënka e sprasme e Balës e G. Darës prej Palac Adrianit të Siqelisë, vepër e frymëzuar prej gurrave të poezisë popullore. Një variacion i emrit ruhet në toponimin *Valikardhë*, katund në pjesën lindore të luginës së Vajkalit. *Vajkal*, te Barleci e në traditën arbëreshe të Siqelisë *Valkal*, si «luginë rrugë» është e burimit roman: Ose prej lat. së vonë *val(lis) callis* «luginë rrugë», ose prej rum. *val(e) cale* me të njëjtin kuptim; sh. për të dyja mundësitë BUST SSS XII (1953) 58 shën. 188, Revue de Ling. VII Nr. 1 f. 181. Në të mirë të mendimit të një burimi latin flet ekzistenca e lat. *vallis* në gjuhën shqipe, sh. *val*, *Valbonë*. Në të mirë të një burimi prej rumanishtes dëshmon prania e disa elementeve rumune bash në krahinë të Dibrës, të cilat (sh. Joklin Rev. Fil. II 263 vv.) kanë depërtuar aty nga të folët e vllëve mesjetarë të Drinit. Rrethanat gjeografike flasin më fort për një burim rumun sesa latin. Prej rumanishtes rrjedh dhe serbokr. *kalja-valja* «ashtu ose kështu, në të dyja mënyrat», nga *calea - valea* «aşa şi aşu», sh. Popovićin Südost-Forschungen XXI 372. Në punë të kronologjisë *Valkal*-i i Barleci e i arbërishtes së Italisë përkundrejt *Vajkal*-it të sotëm dëshmon se në një pjesë të geg. lindore në kohën e shpërnguljes shqiptare për në Itali grupi *lk* ruhej i pazbutuar në *jk* dhe se pra ky zbutim në krahinën rreth Vajkalit u krye pas kësaj shpërngulje; sh. dhe vrejttjet tona në vendin e cituar më parë. Ndërkaq te trajta e ndryshuar *Valikardhë* është ruajtur *lk*, me ndërhyrje të një zanorje në mes të dy konsonanteve. — Sh. edhe *val*.

vajzë f. «gocë; virgjër». Fjalë me burim të diskutuar. G. Meyeri 464 e jep me trajtat *vashë vashëzë vasho*, *vajzë varzë*, te Skiròi *vajë*, dhe nga rreshtimi që bën: *vajzë* e *varzë* emra deminutivë, *vajzë* nga **varjzë*, *vashë* nga **varshë*, lë të kuptohet që merr për primare trajtën me *var-*, po ndonjë etimologji të fjalës nuk jep. Për pjesë tematike përkundrazi merr *-zë-në* e *varzë vajzë-s* Treimeri MRIW I 46, duke e çuar *varzë-n* te një bazë **uord(h)iā*, *vashë-n* te një **uordh-tā* dhe duke e venduar fjalënte grupi ind. e vj. *várdhati* «rritet, shtohet» av. *varəd-* «rritem»

sll. e vj. kishtare *rodъ* «*γένος, γενεά, ἔθνος, partus*» etj. Në kundërshtim me këtë, Jokli (LKU 260 v.) nisët — me G. Meyerin — nga *var-* si formë bazë, gjen të *vashë vajzë varzë vajë* zgjerime të saj me sufikse të ndryshme, dhe sheh të *var* refleksin e një baze **suoró-* «i veti (nga *sue suo-* «vetë»), prej nga u zhvillua kuptim i vajzës. Kundra një afrimi të *varzë-s* me gr. *παρθένος* «virgjër» e me lat. *virgo virginis* nga ana e Bariçit (I 113v.), duke e çuar ky fjalën e shqipes të një **guhorguhī* e të disa shkallë të mëtejme të kësaj, sillet me të drejtë si Jokli (në vendin e cituar, f. 332v.) si Tagliavini 278. Ky dijetar i fundit anon nga etimologjia e Joklit, po Treimeri ndërkaq (Slavia III 455) këtë e gjen të diskutueshme.

Fjalë e mbarë gjuhës, po sot në konkurrencë sidomos me *gocë*, e nëpër dialekte edhe me *çupë*, *cucë* e *çikë*, si edhe me *vashë*, që është e një burimi me të (Kujunxhiqi *vajza*, *cuca* djevica, *çika* djevojka). Ka edhe kuptimin e virgjërës, e përdoret shpesh dhe për «bijë», poashtu si *djalë* për «bir». Nga trajtat e ndryshme në të cilat paraqitet, më e përhapura është *vajzë*, e cila ndërkaq në shumës zëvendësohet shumëkund me shumësin e *vashë-s*. Buzuku ka *vajzë* edhe *vashë*: *Si të thomi se ti thae keq për një gruo o vajzë se kështu bani; e ishnë votë m̄ Israel, e kishnë sjellë robinjë një vajzë të vogëlë* «et captivam duxerant de terra Israël puellam parvulam»; e *vajza virgjënë në martonetë, nukë bie ndë kat* «et si nupserit virgo, non peccavit»; N., a do këtë të rī trim, o vashë N. me e marë për fat veti...?; *E tha Suzana vashëzavet* «Dixit ergo puellis» (XXI/2 b, Testis iniquus; Ll, Mbretërit IV 5, 2; LXXVIII = CVIII, Korintasit I 7, 28; XXVI/2 a; LIV, Danieli 13,17). Ashtu edhe Budi (RR 181, 307, SC 19, 59, DC 181b): *Djali të kietë mbushunë mā pak 14 vjet, e vajza 12; e ndë qoftë vajza e martuome, të thoetë nuseja e N.; o burrë plak i martuom, o djali i rī e j pāmartuom, o gruo m burri, o gruo e vejë, o vajzë e pāmartuome, o nd urdhënit shint, o jashtë urdhëninë; Ku janë ato grā, e vasha, Ndë sqimë e ndë madhështi; E ndeevonë a mos kishnje trajtuom e stolisunë vashëzatë e tua tepërë e pākuor si s do ligja*. Gjithashtu dhe Bogdani (I 47, 1; 120, 8; 87, 6) *kishte faqenë possi një vajzë* «haveva la faccia come di donzella»; *Një vajza ka me zanë, e ka me lēm Bīrrë* «Ecce virgo concipiet, et pariet filium»; *ku e mbërrinë shtatë vashëza* «dove arrivarono sette donzelle»; *vajz-a* (shkruar *vaiž-a*) dhe në Arbënesh të Dalmacisë, Tagliavini 278. Sikundër shihet, kjo është forma letrare e fjalës, përkundrejt së cilës *varza* e Veriut (edhe në Koqa-Gorvokë *T'knoshin varzat për çdo valle*, Jeta e Re maj-qershor 1955, f. 197) mbetet dialektore. Po të kemi parasysh mbizotërimin e *vajzë-s* edhe në toskërishten e në shqipen e Greqisë (Furikis 'Αθηνᾶ 45, 82, Haebler⁶⁷) dhe përdorimin e saj pranë *vashë vashëzë-s* edhe në Itali (khs. dhe Giordanon 523 v., 531), të *vajza* do të shohim formën më të përgjithshme të fjalës. Në ndryshim me të, *vashë* shënon më fort një vajzë të rritur a një nuse të re, në Malsi të Madhe sipas Gazullit *vashë* «grue e re e martueme», të Cimochofski (f. 11, 60, 17, 59) *vajz-a* «fillette», *vāsh-a* «jeune fille», të Kamarda II 92 *Fare nëngë fol'i vasha* «Nulla parlò la giovine» (d.m.th. e shoqja e Kostantinut të vogël), të Sapkarevi 517 thjesht një grua («žena»); në dialektet ku përdoren të dyja, e përgjithësisht në gjuhë, *vashë* (me *vashëz*) ka më fort një përmbajtje poetike, khs. *Vashëza në breg të lumit* në një këngë popullore të Gjirokastrës.

Në hetimin e burimit të fjalës do sqaruar pikësëpari formimi i varianteve të saj dhe puna e përdorimit. Sikundër u pa dhe më sipër,

vajzë e *varzë* janë deminutive më -zë; me -zë dyfishe *vajzëza* e *njomë* «puella» e Bardhit, e cila del si *vajzëzë* dhe në shqipen e Greqisë (Kullurioti te G. Meyeri AS I 84, Haebler 111); për të tilla formime, si *bézëzë* «bahe, hobé» e *unázëzënë*, sh. më lart te *bahe* e te *unazë*, khs. dhe Xhuvani-Çabej, Prapashtesat 109. *vajzë* paravendon si primitiv një *vajë*; këtë e ka Skiròi (Raps. alb. 28) me kuptimin «virgjër», po pas gjithë gjasësh e ka sajuar ai vetë. Një emër hipokoristik (përkëdhelës) si *vajzë* është edhe *vashë*, kjo idealisht nga një **varshë*, formë me sufiks -shë; ky formant është përgjegjësi femëror i -sh-së deminutive, që çfaqet në mashkulloret e tipit *lëmsh*, *Niksh*, sh. edhe Jokli në viset e cituara te Xhuvani-Çabej Prapashtesat 84, ku do shtuar dhe Vox Rom. VIII 195. Ndërkaq, te shumësi *vashaz vashas vashastë* (Pedersen 201, në Greqi *váshazë*, Sotirios Laographia II 108, Haebler 69), i cili — si u tha — shërben dhe si shumësi i *vajzë-s*, kemi të bëjmë me një kolektiv më -as -az, si te *grenas grenaz grénazit grérazitë* (Xhuvani-Çabej Prapashtesat 21), jo me një deminutiv më -zë, si mendon Haebleri 112. Një rrjedhojë e *vajzë-s* është abstrakti e kolektivi *vajzëri vajzni* f. «mosha e vajzës; virgjëria; tërësia e vajzave të një vendi, të një lagjeje», me ndajfoljen e mbiemrin *vajzërisht vajznisht*; poashtu prej *vashë-s* *vashëri vashni*, me *vashërisht*, *vashnisht*. — Në lidhje me përdorimin është me rëndësi që — si e vuri re Pedersen 134 — *vajzë*, në kundërshtim me *bijë* (e *bija*), nuk mban nyjë të parme pranë saj e pra nuk është një emër afërie (f-afërisi), dhe vetëm më vonë ka hyrë, si u tha, në klasën e emrave të afërisë, duke shënuar bijën.

Duke rrjedhur, sikundër u pa, gjithë trajtat e fjalës nga *var-a* e *varzë-s*, kjo fjalë me *vajzë* e me variantet e tjera të saj, rezulton të jetë një deminutiv i *varrë* «plagë», në Dibër *vara-vara* «me vija-vija të gjera, breza-breza» (për një basmë a stof tjetër), *luejmë varash* «luajmë vijën» (në Elbasan *luejmë rrëvazash*), te Weigandi *varrūm* «gestreift, vara-vara», sh. dhe SA I 1 (1965) 18. Vajza është quajtur nga organi femëror, e ky është marrë si «plasë». Për emërtimin e këtij organi si «plasë» khs. lat. e vonë *fissa* «cunnus» në thelb «plasë», bashkë me vazhdimin e saj *fesse* «organi gjenital i gruas» nëpër dialektet e italishtes jugore (sic., napol. abruc.), Walde-Hofmann I 500, Meyer-Lübke REW 3329, gjerm. *Schamritze* «vulva»: *Ritze* «plasë», nga shqipja vetë *ples* «organi i gomares e i mushkës femër: *plasë*, sh. vrejttjet tona LP VIII 82. Për emërtimin e vajzës prej organit femëror khs, nga fusha e shqipes *feçkë* «vajzë e vogël» dhe «cunnus, pudendum muliebre» (sh. *feçkë*), nga gjuhët romane port. *ca(i)* — *xopa* «vajzë» në thelb «cunnus» (Meyer-Lübke REW 1658). Gjuhësisht kemi të bëjmë me një emërtim — eufemistik ose humoristik — pars pro toto, me një sinekdokë. Për ndrimin *r:j* khs. *bir:bij*.

vakër «dele a dash me faqe e me këmbë të zeza». Mungon te G. Meyeri, e jep sëpari Leotti, si (dele) *vakërr* «pecora con muso nero e colle estremità delle zampe nere». Sikundër e pa sëpari Candrea (Gr S VII 291), rrjedh në thelb prej rum. *oacăr* «me njolla të zeza në turi».

Mbizotëron kuptimi i turirit të zi, po ka dhe ndryshime në përdorim. Në Gjirokastër *vakrë* «dele me faqe si në të kuqe». Te Tasja *vakrë* «dele që ka turinj të me ngjyrë të ndryshme nga ngjyra e trupit, sidomos turi të zi a të verdhë me trup ngjyre të ndryshme». Në Zagorie sipas M. Totonit (BUST XVI Nr. 1 f. 213) *vakër* «delja ose dashi pikalosh», veçanërisht në Sheper (pas L. Xhaferit) «delja me fytyrë të murme». Në Nivicë të Kurveleshit *vakërúsh* «dash me faqe të zeza; njeri i zeshkët» (Q. Ha-

xhihasani). Në Piqeras (Bregu i Detit) *vak-a* (M. Totoni), formë retrograde, duke u marrë *vakër* si t'ishte një shumës më *-ër*, khs. *drap* për *drapën*, *-ër*, *kuth* për *kudhër* etj., LP VII 182. — Si fjalë kryesisht e toskërishtes, *vakër* rrjedh nga aromunishtja, *oácårnu* «mouton blanc à la tête (et aux pieds) noire (noirs)». Fjala aromune ka hyrë dhe në dialektet e greq. së re (*βάκρου*, *βάκρινη*, *ἀκρινη*). Höeg II 114, Papahagi 801. Khs. dhe *barçhë*.

val m. «luginë (?). Ruhet vetëm në shprehjen *mal e val: i pasun mal e val*, që jep Gazulli për Malsi të Madhe me kuptimin «i pasur si mali me borë», po që duket të thotë më fort «i pasur mal e fushë, i pasur fund e krye». Në shprehjen *mal e val*, *val* gjan të shënojë të kundërtën e malit, luginën, dhe shprehja do të jetë një merizëm, me kuptimin «mal e fushë, kudo»; khs. për një formim të tillë serbokr. *gore i dole* «posht'e lart», fjalë për fjalë «në mal e në fushë». Pas gjase prej lat. *vallis* «luginë», e cila ruhet dhe në rumanishten. Një burim prej rum. *vale* ose prej it. *vallë*, për arsye dialektgjeografike nuk ka mbështesë. Për një gurrë latine flet kjo, që *Val* çfaqet dhe në Shqipëri të mesme (*Vali i Martaneshit*) edhe në viset jugperëndimore të Jugut: *Val* luginë e lartë (rafshnaltë) midis Vunoit të Bregdetit e Kallararit të Kurveleshit (A. Thani), në Kallarar vetë *Maj'e Valit*, *Qaf'e Valit*, *Vali mesmë* «shesh midis kodrash, quhet i mesmë, sepse janë tre të këtillë», *Vali vogël* «shesh tjetër që ndodhet poshtë Valit të mesmë» (R. Memushaj); në Golem *Vale*, në Kuç *Valth*, në Bolenë *Llëng'e vales*, gjithë emra arash e lëndinash (A. Dhrimo), ku (te emri i fundit) edhe *Llëngë* shënon diçka si luginë. Te *val* kemi të bëjmë me një nga ato elemente latine të shqipes, të cilat nuk ruhen në leksikon e kësaj gjuhe, po kanë mbetur vetëm si relikte në toponomastikën e vendit, sh. *Frakull*, *Groftat*, *Kurbî*, *Pëdhanë*, *Rrjoll*, *Sift*, *Shkortull*, *Shutrrija*, *Vilë*, *Vinjall*. Me këtë mënyrë bie mendimi i Tagliavinit (f. 285) që lat. *vallis* nuk duket të dëshmohet në gjuhën shqipe. Emrin e malit *Resht Valorit* afër Ungrejt në Mirditë Jokli ZONF X 199 e bie të ardhur prej një rum. **valiora*, deminutiv i *vale* «luginë». Sh. dhe *Vajkal*.

valanicë f. «dërstilë». Fjalë e gegërishtes, që mungon te G. Meyeri. Sikundër e vuri re Kristoforidhi (f. 14,485), huazim sllav. Sh. dhe Selishçevin 170, Gazullin 448, Barićin Hýmje 79.

Në Mirditë sipas Nopcsës 134 *valanecë*, me hapje të *i-së* në *e* në atë dialekt, në Pukë pas Gazullit *vaanicë*. Si e kemi shënuar dhe në BSS III (1954) 71, nuk kemi të bëjmë kudo me një huazim prej bullgarishtes, si mendon Kristoforidhi; po me një huazim serbokroat në geg. veriore, e bullgar. (*valjavica*) në geg. lindore.

valë f. «të ngriturit e ujit në det, në liqen a në lumë, kur është në lëvizje; një të zier të ujit, të qumështit etj., gjersa të gurgullojë, si mbiemër «shumë i nxehtë»; papare, paçamur; të sjellurit e një lodre»; *valój*, *vëlój vloj*, *përvëlój*, në Greqi e në Kalabri *sualë* «dallgë». Sikundër dihet që nga G. Meyeri (BB VIII 191, Fj. et. 462, AS III 38, 77) e këtej, formë apofonike e grupit gjerm. e lartë e vj. *wëlla* «valë» *wallan* «me value» nord. e vj. *vella* «me zie, me valeu», sll. e vj. kishtare *vlъna*, lit. *vilnis* let. *vilna* «valë», ind. e vj. *ūrmis* «shkulum, valë» etj. Për formën bazë të fjalës së shqipes gjuhësia me kohë është larguar nga mendimi i G. Meyerit, që *valë* me *-a-në* e saj reflekton një formë bazë me *-o-*, dhe ndjek përgjithësisht Brugmannin (I² 365), i cili *-al-in* e *valë-s* e bie të ardhur nga një *l* sonantike e gjatë, *valë* nga **ualnā*, indoeur. **ulna*: Brugmann I 475, Jokl (LKU 270 v., Wus XII 68, Die Sprache IX 122), Boisacq 225, Walde-

Hofmann II 833, Kluge-Götze 669 e 683, Walde-Pokorny I 301 e Pokorny I 1142 (këta **uelenā*). Khs. dhe Pušcariun (Zur Rekonstruktion d. Urrumänischen, Festschrift W. Meyer-Lübke 56), Tagliavinin 285 (me *vlua*), Vasmerin REW I 218, Barićin Hymje 51, Georgiev-Гълъбов-Zaimov-Илѣв 207. Vetëm La Piana (SLA Varia 48) i mbahet gjer diku mendimit të G. Meyerit, duke shtruar për bazë të fjalës një indoeur. **uol-nā*.

E mbarë gjuhës. Buzuku (p.sh. XXX, Luka 21, 25) e *mbë dhët shumë t idhunë përmbi gjint për kaqë të lëkundunë qi të lëkundetë deti n valëshit* «et in terris pressura gentium prae confusione sonitus maris et fluctuum». Bardhi Unda *Vala*, Unda maris *Vala e dëtit*. Folja *vëlon* në Gjirokastër me metatezë *lëvon*. Denominativi tjetër, *valavitet, valvitet* «valon në erë» (për një flamur etj.) është një formim i ri. Popullor kompoziti *valbukë* f. «gjym i vogël, ibrik zjarri» (FGS), në Krujë (ER, te Manni) *valbuke* «një lloj përseshi», fjalë me topikë të përkundërt nga ç'e ka *bukëvale* (sh. këtë fjalë). Nga *valë* mbiemri i *valë, i valët* «shumë i nxehtë». Me *-omë* abstrakti *valomë* «rrymë, rrjedhë», në shprehje si *na mori valoma*. Me *-zë valëz* «rrudhë» te Drizari. Nga *përvëlloj* postverbali *përvëlák* m. «mëmëligë; fëli», në Greqi (G. Meyer AS V 98) *përvëliq* m. «elb me dhjamë derri» e *përvëlorë* f. «një lloj valë me bukë të fërguar me dhjamë derri». Historikisht *valë* në punë të shkallës apofonike të *a-së* së saj mbetet e dykuptimshme. Kjo mund të ketë rrjedhur poashtu nga një *o* sa dhe nga një likuidë silabike. Vetëm se baza nuk mund të jetë një **voljā* (G. Meyer, *lj* do të kish dhënë *j*), po (me La Pianën) një *vol-nā*. — Sh. dhe *valikë*.

valikë f. «kohë e përshtatur për punët e bujqësisë». Fjalë e geg. veriore, mungon te G. Meyerit. Del me këtë formë e përdorim sëpari te Bashkimi, «tempo acconcio ai lavori d'agricultura». Është një zgjerim i *valë-s* me *-ikë*, sufiks që formon emra femërore, si *thërmikë*, sh. për këtë formant Xhuvani-Çabej Prapashtesat 51. Kuptimi i parë gjan të ketë qenë «valë, të nxehtë», prej nga u zhvillua «valë e punës, koha kur vlon puna». Kështu Junku jep përpara Bashkimit *valik-a* «bollimento, onda; *valika e puns* «tempo acconcio a lavorar la terra». Edhe Lkëni i Hasit (Gjeçovi) te Albania (X Nr. 2, 1906, f. 28) e *kur e pa se zu m'e bredhë valika e tokës prej rrezeve t'perflakta t'djellit*. Edhe sot fjala përdoret më shumë së bashku me *punë-n*; atje ku përdoret vetëm, specializimi i kuptimit (si p.sh. edhe te Rrota, Rreth votrës 61 në *valikën e vadës*) do t'u ketë kryer me anë të një elipse.

vanderë f.: sh. *panderë*.

vanë f. «një e gërryer si ulluk që i hapet një dërrase për së gjati, që të futet në të një tjetër dërrasë»; *vana e pusit* «rrethi i sipërm i pusit». Fjalë e geg. veriore, që del me këto kuptime te Gazulli. Më parë D. P. Suli (HD VI 243) jepte për Mirditë *vana-t* shm. «shenjat, mbresat që kanë mbetur nga plaga që ka lënë një gur». Gazulli jep për Malsi të Madhe edhe shm. *vazat e shulit të vekvet*, si sinonim të *vana-ve*. Sikundër e kemi treguar dhe në LP VII 166v., *vanë* nuk është veçse shumësi i *va-ut*, i përdorur më fort si shm. *vana-t*, po mbase nganjëherë dhe si njëjës *vanë*, e kështu në thelb një me *və vani* «luginë», sh. këtë fjalë. Edhe në të tjera gjuhë kuptimet e *vaut*, kanalit, luginës e *vanës* piquen, sikundër shihet ndër të tjera te reflekset e lat. *canalis* e *vallis* në gjuhët romane, te Meyer-Lübke REW 1568, 1934.

vang vëng m. «rrethi i drunjtë i rrotës, ku mbërthehet rrethi i hekurt; gavelli i rrotës; *vangu i opangës* «gjalmat e lëkurta për të lidhur opingat në këmbë, dredhat». E afrojnë përgjithësisht, që prej G. Meyerit (f. 463,

AS III 66, 87) e këtej, përbrenda gjuhës më i *vëngër e vangósh* «që shikon shtrembër nga shkaku i një të mete që ka në musklat e syve, syll», e më tej me lit. *véngiu* «i bëj lak, e evitoj» *vingis* «hark, lakesë», përkulje » *vingùs* «i shtrembër, i përkulur», let. *wanga* «dorë e një ene», gjerm. lartë e vj. *winchil* «kënd, qoshe» etj. Sh. Weigandin 97, Joklin LKU 103 e Arch. Rom. XXIV f. 39 (e ekstraktit), Walde-Pokornyn I 218, Walde-Hofmannin II 727, Pokornyn I 1148, Kluge-Mitzkan 839.

Ndrimi *a:ë* në pozicion nazal dëshmon për lashtësinë e fjalës. Në gegërishten, *vang* edhe «shkak, pretekst», me një kalim metaforik nga konkreti në abstrakt, si te *rrëfanë, vjegëz*, edhe te vetë *shkak*. Mbiemri gegërisht edhe *i vangët*, toskërisht dhe *i vëngërt e vëngarash*, emri *vëngëri* f. Folja geg. *vangnoj*, tosk. *vëngëroj* «shikoj shtrembër, jam i vëngërt».

vardúe m. «Chloris chloris, zog këngëtar, një lloj borsi me ngjyrë të gjelbër të mbyllët». Mungon te G. Meyeri. E jep sëpari Junku, si *vardúu,-doni* «verdone, uccello». Sikundër e pa Helbigu 42 e 135, vjen prej it. *verdone* me të njëjtin kuptim; khs. edhe Mannin 545. Për një burim italian (e jo latin) flet dhe përhapja e kufizuar e fjalës, që është vetëm e dialekteve të geg. veriore. Në qoftë se pranë *vardoni*-t ekziston dhe trajta *vardi,-ni* që jep Godini te *Grünfink* (të tjerët s'e kanë), kjo është formuar me zëvendësim të sufiksit *-ue, -oni* (këtu prej it. *-one*) me amplifikativin *-i -ini*, si në *hutí, shatí* etj., sh. për këtë Xhuvani-Çabej Prapashtesat 48v. Fjala e italishtes ka hyrë dhe në greq. të re, si *βαρδοῦνι*, G. Meyer NS IV 18.

vargër vërgâ m. «dash a cjav (edhe kalë) i patredhur». Për variantet e shuma të kësaj fjale (*vërgár*, në Greqi *vërgá* e *vergár*, pl. *vërgënjë, vargër*, Dozoni *bárgërë*) G. Meyeri 470 (sh. dhe IF 6, 113, AS V 104, 105) jep burime të ndryshme: *vargër* e nxjerr nga rum. *vargã* «thupër» (kjo nga lat. *virga*), si një fjalë me burim nga gjuha e barinjve vllah; *vërgár* e spiegon nga lat. *virgarius*, *vërgá* nga një lat. e paravenduar **virganus*, të gjitha nga *virga*. Kështu më parë dhe Stieri (Nr. 32) *vërgar*-in e Reinholdit e kishte qitur prej lat. *virgarius* it. *vergaro*. Khs. dhe Meyer-Lübken Gr Gr I² 1048, Puşcariun EW 1858.

Fjalë e mbarë gjuhës. Ekzistojnë edhe *vargës* e *vargëz*. Trajta *varg-u* e Nivicë-Bubarit në Breg të Detit (M. Totoni SF XVIII=I, Nr. 2 f. 134) ka dalë nga shkëputja e rrokjes së fundit (*-ër*), e cila u ndie sikur t'ishte shenja e shumësit, ashtu si *drap* për *drapën, -ër, kudh* për *kudhër*, sh. LP. VII 182. Një zgjerim i geg. *vargën* = tosk. *vargër* është *dashi vargënuer* në Ljarje e Shestan, te D. Kurti HD XIV 90. Në Sulovë *vrogëz*, Q. Haxhihasani BSS 3 (1955) 187. Në Myzeqe me *vërk vërk vërk* i thërrasin dashit kur i hypën deles. — Për etimologjinë do thënë se s'është mundur që një e vetme fjalë me format e ndryshme të saj të ketë tri burime të ndryshme. Baza e fjalës është *varg-*; *vërgâ* spiegotet ashtu si *shpërgâ* nga *shpargën shpargër*; poashtu sekundare janë edhe *vërgá, vërgár* e të tjerat forma më *-ë-* paratheksore. M'anë tjetër do pasur parasysh që në traditën latine nuk ka **virganus*, dhe *virgarius* është vetëm e ndonjë glose. Të tilla forma nuk rrojnë as në gjuhët romane, në të cilat përveç kësaj as primitivi *virga* nuk ka marrë ndonjë kuptim që të afrohej me atë të *vargër*-it. Sikundër e kemi shënuar dhe më parë (LP VII 104v., Revue de Ling. VII 1 194, BUST SSS XVI, Nr. 4, 1962, f. 127, 143, SA I, 1, f. 81) *varg-* te *vargër vargën- vargës vërgâ vërgár* etj. është një me *βαρῖχοι ἄρνες Λάκωνες* që jep Heziku; kjo është një nga elementet e shqipes

së stërmoçme në dialekt të Dorasve. β -ja e $\beta\acute{\alpha}\rho\iota\chi\omicron\iota$ do lexuar *v-*, në pajtim me shqiptimin e greqishtes në kohë të Hezikut (shek. i VI. i erës së re), sh. Schwyzer Gri. Gram. I 233. Një fjalë thjesht greke sheh Densusianu (Gr. S I 140v.) të $\beta\acute{\alpha}\rho\iota\chi\omicron\iota\text{'}\acute{\alpha}\rho\upsilon\epsilon\varsigma$, të cilën e afron brenda greqishtes me $\beta\acute{\alpha}\rho\iota\omicron\nu\text{'}\pi\rho\acute{o}\beta\alpha\tau\omicron\nu$.

varkë f.: sh. *barkë*.

varósh m. «lagje e një qyteti, që gjindet jashtë mureve, në anë të qytetit dhe përkundra çarshisë; lagje e krishterë». Fjalë me burim të diskutuar. Pas G. Meyerit 464 prej turq. *varoş*, kjo prej magj. *varosz* «qytet». Afërsisht kështu edhe Selishçevi 259 mendon që fjala magjare u përhap në shek. XV-XVI nga trevat kufitare magjaro-turke. Jokli përkundrazi (Ungar. Jahrbücher VII 54vv., Slavia XIII 631v.) mendon se fjala magjare ka hyrë në shqipen jo me anë të turqishtes, po nëpërmes të serbokroatishtes, në periodën paraturke. Si fjalë magjare e shënonte edhe më parë Dozoni 97.

Fjalë e mbarë gjuhës. Del që te Buzuku (XLIII, Marku 6, 56): *E mbë gjithë visë o ndë varosh o ndë katund o ndë qytet vinjinë të sëmunitë ndë pjacat* «in vicos vel in villas, aut in civitates, in plateis ponebant infirmos». Burimi i pandërmjemë i fjalës shqipe nuk mund të ndahet në mënyrë të prerë. Ndërsa dëshmia e Buzukut lë të hapur derën e të dy mundësive, mungesa e fjalës në dialektet arbëreshe t'Italisë do të dëshmonte më fort për depërtimin e fjalës në kohën turke e pas shtektimit shqiptar për në Itali. Edhe Georgiev-Gлѣбов-Zaimov-Ilčev 121 për bullg. *varoš* e lënë të hapët çështjen e ndërmjetësimit, a të serbokroatishtes a të turqishtes.

vec m.: sh. *kastravec*.

verzë, *vercë* f., më fort si shm. *verza verca* «organet me të cilat marrin frymë brenda në ujë peshqit e disa të tjera shtazë ujëse», edhe *vëlëza* e *vele*. G. Meyeri 467 «branca di pesce» të Junkut e jep gabim me gjerm. *Flosse*, që shënon pendët e peshkut, dhe kështu e spiegon fjalën nga sllavishtja, serbokr. *brk* «mustaqe» çek. *brk* «sustë.» Selishçevi me të drejtë nuk e rendit këtë fjalë ndër huazimet sllave të shqipes. Weigandi 98 nuk jep ndonjë etimologji, po bashkon vërtet *vercat* e peshkut me *vercat* «veshëzat e parmendës, llapari», njëkohësisht duke spieguar *veshëzë-n* e parmendës si një deminutiv të *vesh-it*, si «vesh i vogël». Jokli (LKU 137vv.) sheh këtu dy fjalë të ndryshme: *veshëzë-n* e parmendës e merr për një përkthim të lat. *auris* shm. *ures* «vesh»; në *vercë-n* e peshkut e të parmendës gjen refleksin e një postverbali latin **vertia* nga *vertere* «me kthye, me sjellë m'anë tjetër.» Sh. dhe Dacoromania III 818, IV 1398.

Spiegimin e gabuar të G. Meyerit e vuri re edhe Manni 550. Sikundër e kemi shënuar dhe gjetkë (LP VII 164v., Revue de Ling. VII 1 194), kemi të bëjmë me një fjalë të vetme e thjesht shqipe, me *vesh-in*, e cila mori trajta e përdorime të ndryshme. Te peshku *verzat* janë «veshët», në shqipen e në të tjera gjuhë, khs. gjerm. *Fischohren*, frgj. *ouïes*, rum. *ureche*; nga *verzë* edhe emri *verzakuq* i një peshku, që Gazulli e jep gjermanisht me *Rotfeder*, po pa shënuar ubikacionin. Po edhe *verzat* e parmendës janë «veshët», khs. *veshët e parmendës*, në Mirditë *veshezt e parmendës* (D.P. Suli te Cordignano² 737vv., Bindoni 59, 93, 188), poashtu *veshezt* në Seman të Fierit (J. Thomaj, Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës. Seria Shk. Shoq. 4, 1961, 153), Tase *veshëzë*, në Selishtë të Matit (sot Dibrës) *veshas* (Dh. Liperi); khs. frgj. *oreille d'une charrue*, katal. *auriyera* «ve-

shëz e parmendës», Meyer-Lübke REW 793. Në pikëpamje fonetike, te *veshëz* ra *sh*-ja para *z*-së, dhe u zhvillua, si shpeshherë, një *r*, duke u arritur kështu te *verzë*. Trajta *vercë*, me *-cë*, është e geg. veriore, sh. Joklin në vendin e cituar, e Xhuvani-Çabej Prapashtesat 28. — Si e vuri re Jokli, rum. *bîrță* «veshëz e parmendës» rrjedh prej shqipes.

vezullón «shndrit» (thuhet për armë, për xixëllojën, për yjtë, kur u shkon e u vien drita); *vezullojë* f. «xixëllojë»; *vezullim* m. Këtë fjalë G. Meyeri 469 e jep te *vetëtinj*, me trajtën *vishllonj*, *vishllim* m. «xixëllojë», dhe bashkë me *vetëtinj* e spiegon nga sllav. *svētiti* «me shndritë», serbokr. *svitac svitaljka* «xixëllojë». Selishçevi s'e numëron ndër huazimet sllave të shqipes.

Kjo etimologji nuk është bindëse nga ana fonetike, sepse thjeshtimi i grupit *sv* në *v* në ballë fjale i përket periodës prehistorike të shqipes, kështu që nuk rrok huazimet sllave. Një dëshmi e Buzukut tregon se fjala i përket fondit të gurrave autoktone. Te ky autor gjejmë (LXXXV = CV, Libri i Urtës 3, 7) *Të dërëjtëtë të shkënxënjënë porsî dhezëllima ndërper kallëmit* «Fulgebunt iusti, et tamquam scintillae in arundineto discurrunt». Kjo *dhezëllimë* me kuptimin e shkëndijës shihet se është një post-verbal me *-ull-imë -ëll-imë* i *dhez* «ndez». Aty hyn dhe *vezulloj* me gjithë rrjedhojat e saj. Ndrimi i spirantit *v* në *dh* është mjaft i shpeshtë, khs. *vampir: dhampir*, *vjoli: dhjoli*, *ajovimë: ajodhimë* etj. I përkundërti na del te *vezull-: dhez*. Trajta *dhez* për *ndez* gjindet edhe në geg. veriore, ndër të tjerë dhe te Buzuku. Ruhet m'anë tjetër, sikundër shihet, dhe te *vezullon*, sh. dhe SA II 1 25. Trajta me *-i-* në rrokje të parë: *peshqit vizlojnë n'uj* (Gazulli), Bashkimi *vizloj* «riconoscere al viso o all'effigie, luccicare», te Junku me *vislue*, i detyrohet ndrimin të *-e-së* në *-i-* në rrokje paratheksore, *vezloj: vëzloj: vizloj*; te *mos më vizlo* «mos më luej, mos më nguc» po te Gazulli duket të ketë ndikuar dhe fjala *lëviz*. Tjetra trajtë me *-i-*: *vishllonj vishllim*, që jep G. Meyeri pas Rossit, nuk duket të jetë e sigurtë. Po do pasur parasysh dhe *vershloj* «vezullon (rrufeja)» te Lambertzi 212.

vërshëllëj: sh. *fërshëllëj*.

vërshój: *vërshon lumi* «del lumi shtratit», figurshëm «dal jashtë kufirit, e tepëroj (me fjalë a me të bëme)»; *vërshim* m. «përmbytje, boenë». Pas G. Meyerit 470 prej lat. *versare*, mendim i pranuar dhe te Puçariu EW 1861.

Del sëpari te Budi DC 195b: *E Avisi u tfunduo, Lëqejtë i debërtoi, Mbë gjith anët u vershuo, Gjithë dhënë e mbuloi*. Sikundër e kemi shënuar shkurt dhe në Revue de Ling. VII 1 171, burimi i kësaj fjale prej latinishtes mbetet fort i dyshimtë. Nga pikëpamja latine do shënuar se *versare* ka pasur kuptimin «rrotulloj, rrëkëllej, sjell, kthej» dhe se në gjuhët romane del vise-vise domethënia e të derdhurit (në rumanishten, frengjishten etj.), po asgjekund ajo e përmbytjes. Nga pikëpamja e shqipes është për të vënë re se te i pari burim, te Buzuku, për «vërshoj» gjindet *lëshoj: e n voeset së tî me të madh të lëshuom neve na mbushtë* «et sui roris intima aspersione foecundet»; poashtu Bardhi ka Restagnare *Me lëshuem ujëtë*, Restagnat Drion *Lëshon Drini e mer fushënë*. Afrimi i kuptimeve që kanë *vërshoj* e *lëshoj* tregon se s'është e mundur të ndahen këto dy fjalë nga njëratjetra. Baza e *vërshoj* është *lëshoj*, po me atë kuptim që ka kjo në shprehje si *na lëshuan qentë, ka lëshue ujë i madh, lëshuan ujërat, i lëshohem* «i vërsulem, i derdhem». Te *vërshoj* ka ndodhur një diferencim formal i *lëshoj* me anë të prefiksit *vër-* (khs. *sulem: vërsu-*

lem), duke zëvendësuar ky rrokjen nistore *lë-*. Ndërkaq një ndikim i lat. -romanes *versare* nuk është fare i pamundur.

vërrí f. « hulli (e vogël) ». Këtë fjalë G. Meyeri 37 e shënon pas Hahnit si *vëri* e me kuptimin « rruvi e dorës, vijë në një brinjë », dhe bashkë me atë dijetar e lidh përbrenda gjuhës me *vërë vrimë* e me *birë*. Jokli (Studien 94v.) nisat nga trajta *vërrí* e Kristoforidhit dhe e afron fjalën me lat. *versus* « hulli, rruvi, vizë, rrjesht » *verro* « tërheq rrëshqanë, fshij », nord. e vj. *vorr* « të rrahur rremash », duke caktuar për fjalën e shqipes një bazë **ver-n-ija*.

Sikurse e kemi shtruar në Bul. për Shk. Shoq. 3 (1954) 60, *vërrí* është një zgjerim me *-í* i *varrë-s*, me reduktim të rregullt të *a-së* së patakse në *-ë-* në trup fjale, si te *gaz: gëzoj, lavd: lëvdoj*. Le të kemi parasysh që *varrë* përveç kuptimit të plagës ka dhe atë më të përgjithshmin të rruvisë, vizës, rrypit, te Bashkimi « grado, striscia ». Me këtë piqet *vara-vara* « me vija-vija të gjera, breza-breza » (për një basmë a stof tjetër) që përdoret në Dibër, për të cilën në Elbasan thonë *vërríja verrija* (M. Domi). Një formë metateze e *vërrí-së* është *rruví rrëví*; me atë lidhen dhe *vurratë vërratë e vrragë*, sh. këto fjalë.

vgjollë f. : sh. *gjollë*.

vigje-t fpl. « dhurata a ushqime që çohen me rastin e një martese a të një lindjeje, a kur ndërtohet një shtëpi e re; darka që shtrohet të tretën natë të lindjes së djalit a të vajzës ». G. Meyeri 472 këtë fjalë të Mitkos e lë pa spjegim etimologjik. Jokli (Studien 95v.), duke u nisur nga mendimi se *gj-ja* mund të jetë refleksi i një grupi *gl (vigle)*, bën — me rezervë — një afrim me gr. *ἔδνον* « mergjur i dhëndrit për nusen, rushat », gjerm. e lartë e vj. *widomo* « mergjur, rushat », sllav. e vj. kishtare *veno* « pajë, prikë; mergjur »; baza e fjalës shqipe sipas tij një **ved-l-*, me ndrim *dl: gl: gj* e me zhvillim të *e-së* në *i* para dy konsonanteve. Spjegim që e pranon Thumbi Gött. Gel. Anzeigen 1915 f. 26 e Hofmanni GEW 69, po që Pokorny I 1116 e jep si të pasigurtë. Sh. dhe Walde-Pokornyn I 256, J. Loewenthalin WuS XII 17, Boisacqun 1107.

Është shumësi i fjalës *vig* « një tra që vihet si urë e që shërben për të kaluar një ujë; shtizë e parmendës; shkalc, tabut i thjeshtë », e cila përdoret dhe si shumës i singularizuar *vigje* fem. Është një sinekdokë: emri i bartësit, i dërrasës ku vihen dhuratat e ushqimet, kaloi në atë të përmbajtjes, të vetë këtyre dhuratave e ushqimeve. Të tilla kalime kuptimesh janë të shpeshta në këtë fushë. Khs. prej shqipes vetë *mësallë* « darkë, gosti », te Hahni *i bëri një mësallë* « i shtroi një darkë, një gosti », pastaj *tryezë* « gosti », *siní* « petkat që i dërgon dhëndri nuses » pl. *sinitë* « dhuratat që i dërgon nuses ana e dhëndrit », në shqipen e Greqisë *var-garë* f. « varg me florinj i nuses » e « pajë, prikë » (Meyer 475). Prej gjuhësh së tjera khs. gr. e re *κανίσκι* « dhuratë », e cila lidhet me *κάνιστρον* « shportë » *κάνιστρα* « kosh i madh » gr. e vj. *κάνειον* « lloj koshi i cekët, thurur me kallma », *ἀνακαλυπτήρια* « e treta ditë pas martesës, në të cilën nusja e re u del zbuluar farefisit e miqësisë; kanisqet që i bëhen nuses në atë ditë »; angl. *board* « dërrasë, tryezë; pension »; frgj. *corbeille* « shportë, kaçile »: *corbeille de mariage* « kanisk që i bën dhëndri nuses ». Ekziston dhe kalimi semantik i përkundërt, nga abstrakti në konkretin, si te *kolendër* « kulaç i vogël që ndahet natën e kolendrave », sh. G. Meyerin 196, Bernekerin I 67, *meshë* emër i një lloj buke etj. — Me *vigje* lidhen, si kompozite me *kor(ro)-* e *kala-*, fjalët *koroviçe* « petulla pak më të vogla se petullat e tjera, fërguar në tigan me vaj o me gjalpë e dredhur

si flutura, që shpien gratë kur venë për urim në një lindje» (Tase) e *kalaviçe* «festë e lindjes, poganik» në Shqipëri të mesme. Edhe këto kompozite të *vigje*-ve janë shumë si kjo vetë, e si shumë emra festash. Sh. për këto «shumëse intensiteti» LP VII 161.

vigjës f. «Vicia, grashinë». Mungon te G. Meyeri, e jep Gazulli për të folët e Mirditës. Sikundër e kemi shënuar dhe në Revue de Ling. VII 1 197, vjen nga lat. *vicia*, latinizëm i shqipes i pavënëre gjer më sot. Për arsye fonetike nuk mund të rrjedhë prej it. *veccia*. Si refleksi i parë i lat. *vicia* do të mendohet një **viqë*, me reflektim të rregullt të *k*-së latin me palatal në shqipen, duke hyrë kjo fjalë kështu në atë shtresë fonetike ku bëjnë pjesë dhe *qepë faqe qiqër* etj. Kjo **viqë*, në geg. veriore, me sonorizimin e rregullt të konsonantit të rrokjes fundore në atë dialekt, e me shtesë të sufiksit *-zë*, dha *vigjës*; për këtë formant në emra bimësh sh. Xhuvani-Çabej Prapashtesat 108. — Fjala latine ka depërtuar dhe në gjermanishten (*Wicke*) e në greq. e re ($\beta\iota\kappa\acute{\iota}\alpha$), sh. Kluge-Mitzka 858, G. Meyerin NS III 15. Prej gr. së re, $\beta\acute{\iota}\kappa\omicron\varsigma$ ka kaluar në shqipen e Greqisë si *vik*, *vik i égjërë*, sh. G. Meyerin AS V 105. Në Shqipëri është formuar dhe kompoziti *mollvigjës*, te Mitrushi 106v. edhe *mollëviçe*, *vadhëviçe* etj. «*Sorbus torminalis*, S. aria».

visár, **vistár** m. G. Meyeri 471 e jep si *vështár vishtár* dhe bashkë me *vishtor* «ruajtës» të Rossit e lidh me *vështoj vështroj*.

Tek autorët e vjetër të Veriut mbizotëron forma *vistar*: Khs. prej Buzukut p.sh. e *ñçilnë vistarë e tyne i ñfalmë dhunëtī e ār, kiem e mirë* «et apertis thesauris suis obtulerunt ei munera, aurum, thus, et myrrham» (XXXVII, Mateu 2, 11), shpeshherë së bashku me *ār* (sh. këtë fjalë); po lat. *thesaurus* ai ndërkaq e jep edhe vetëm me *ār*, si *ār i pāçmuom* «infinitus thesaurus», ose me *begatī*: *Mbë këtë shembëlltyrë anshtë regjēnia e qiullet: begatija e ñfshēhunē ndē një arē* «Simile est regnum caelorum thesauro abscondito in agro» (LXXXVI/2 = CVI/2, Libri i Urtës 7, 14; LXXXVIII/2 = CVIII/2, Mateu 13, 44). Budi (DC 55, RR 55) *E mos i dēshēro as kānē, as kālīnē, as bashtinēnē, as vistārrē; ashtu qi j atilli vistār aspak të mos ēpetē atyne qi as me ndōnjē arrēsye s e meritonjēnē*, sh. dhe DC 182, RR 331, SC 65. Bogdani (I 37,21; II 21, 12) *Aj qi nxier Erētē prej visareshit së vet* «Qui producit Ventos de Thesauris suis», *ndo visari ndē Arat* «ò pure Thesaurus in Agro». E ka edhe N. Keta i Sigelisë (Contessa Entellina): *E ktē vistār qēndisi e shkroi*; edhe Z. Skiròi (Canti tradizionale 74) ka *i taksēn.... gruas të bukur e burrit vistare* «... promette... alla donna bellezza ed all'uomo tesori». Sikundër e kemi shënuar në Revue de Ling. VII 1 185, kjo fjalë, bashkë me rum. *vistier* «arkë e visarit; ruajtës i visarit», rrjedh nga gr. bizantine $\beta\iota\sigma\tau\acute{\alpha}\rho\iota\omicron\nu\ \beta\iota\sigma\tau\acute{\alpha}\rho\iota\omicron\nu\ \beta\epsilon\sigma\tau\acute{\alpha}\rho\iota\omicron\varsigma$, kjo vetë prej lat. mesjetare *vestiarius* «ruajtës petkash». Për fjalën greke-bizantine sh. Triandaphyllidis 134 e 153, për fjalën rumune Tiktinin III 1758v. Prej rumanishtes rrjedh bullg. *vistrija* «një vend ku thonë se kanë fshehur një visar», sh. Georgiev — Гълъбов-Zaimov-Ilčev 153. Në dokumentet e Shqipërisë mesjetare ndeshet titulli greko-latin (bizantin) *protovestiarius*, sh. Acta Albaniae I 725, II 706, gr. $\pi\rho\omega\tau\omicron\beta\epsilon\sigma\tau\acute{\iota}\omicron\varsigma$. Nga dy trajtat e fjalës shqipe, *vistar* e *visar*, e para është më e vjetra e më besnikja ndaj gurrës bizantine. E dyta, e cila nuk çfaqet para Bogdanit, ka humbur *-t-në*, nga sa duket, nën ndikim të *ar-it*, me të cilën fjalë del shpeshherë së bashku *vistar-i* (*ār e vistār*) te autorët e vjetër. Ndërkaq do vënë re se në greq. bizantine fjala latine pësoi një ndryshim semantik, duke kaluar

nga ruajtësi i visarit të visari vetë, e me këtë ndryshim paraqitet dhe në shqipen e rumanishten.

vishkëlloj: sh. *fishkëllój*.

vishtat (të) fshm. «të lashtat kur janë në arë, bulqitë, grynjërat». Mungon te G. Meyeri, e jep sëpari Bashkimi, si «cereale sul campo». Jokli (LKU 213v.) e lidh përbrenda gjuhës me *vjeshtë*, me *visharak* «pëllor» e me *vesh* (*rrush*). Nga këto krahasime, dy të parat janë të sigurta. Mbetet për të sqaruar ndërkaq forma e fjalës: më një anë karakteri i saj si mbiemër i substantivuar përkundrejt substantivitetit të mirëfilltë *vjeshtë*; më anë tjetër *-i-ja* ndaj *-je-së* së *vjeshtë-s*. Khs. për këtë *vit: vjet*.

vitërk m. «njerku». Mungon te G. Meyeri. Nga lat. *vitricus*, që rron dhe në rumanishten, në sardishten e në disa dialekte të Italisë jugore, Tagliavini Stratificazione del lessico albanese 127v., Mélanges M. Roques III 255vv. Sh. dhe Alesion Annali d. Fac. di Lettere e Filos. Bari I 52. Është një nga ato elemente latine që shqipja i ka të përbashkëta më një anë me rumanishten, më anë tjetër me sardishten e italishten jugore. Sh. për këtë dhe vrejttjet tona në Revue de Ling. VII 1 173v., 197. Një burim prej rumanishtes ndërkaq nuk përjashtohet.

vitore f. «figurë e besimit popullor, që përfytyrohet si një gjarpër me bri të arta e që pjell flori; roja e shtëpisë, që besohet se është një gjarpër i shkurtër e i trashë, grua që ka lindur shumë fëmijë; një nga tri fatitë që i vijnë foshnjes të djepi të tretën natë të lindjes e që i shënojnë fatin». Për këtë fjalë, mendimit të Hahnit (f. 162, 201 shën. 80) që ajo do të thotë «plakë, plakarushe» e që ka lidhje me *vit vjet*, i mbahet gjer diku Stieri Nr. 144, pastaj G. Meyeri 475 (duke i dhënë fjalës gabimisht edhe kuptimin «plakë që i bën vajne një të vdekuri», gjë që tregon se e ka ngatërruar aty me *vajtore*), Weigandi 100, Lambertzi Alb. Märchen 39v., e tani rishmë Marlekaj te Vjet. 239 shën 82. Treimeri përkundrazi (Arhiv I 27v.) e merr si «hie e shtëpisë» dhe e afron kështu me lit. *vetà* let. *witta* «vend», duke menduar një zhvillim kuptimi si te rus. *domovoj* e bosn. *kučarica*, emra hiesh që kanë dalë prej emrit të shtëpisë (*dom, kuča*). Xylanderi e spiegonte nga lat. *victoria*.

Fjalë e anëve të Toskërisë, që arrin gjer në Shqipëri të mesme, formim jo shumë i vjetër. Në Çamëri, krahinë anësore e si e tillë konservative e truallit gjuhësor të shqipes, sipas Pedersenit 205 vitoret janë tri fatitë që shënojnë fatin e foshnjes të tretën natë të lindjes së saj. Prandaj *vitore* reflekton një *vejtore*, dhe lidhet me *vegj* ose me foljen *vej*, si «ajo që ven, që end pëlhurë». Emri i kësaj figure ka të bëjë me besimin që vitoret ose fatitë tjerrin fillin ose endin pëlhurën e jetës së njeriut. Kjo ide qëndron dhe në bazë të emrave të këtyre figurave të tjerët popuj të Gadishullit ballkanik, rum. *ursite ursitoare urzitoare: urzi* «end pëlhurë» prej lat. *ordire*, serbokr. *sućije: sući sukati* «dredh lesh, tjerr», sh. Revue roum. de Ling. X 101 v. Forma *vejtore* nuk na ka dalë, po ekziston paralelja *vektuer* fem. *vektore*, nga *vek, me bâ vek* «bëj pëlhurë në vegjë.» Për ndrimin *ej:i* (*vejtore: vitore*) në dialektet më të ndryshme të shqipes khs. *këndiparë* «këndeje e tej» nga *këndejparë* (Vreto), *lejlak: lilak, mejhane: mihane, shejshane: shishane*, në Gjakovë pri *ksaj* «prej këndeje, od ovoga» (Kujunxhiq), në Dibër *i ndritë* «i drejtë», *pi* «pej, prej», *më riti* «më rrejti», në Opar *mitonin* «mejtonin», në çamërishten vetë *gjinë* «gjejnë» e *hibé* «hejbe», te Pedersenit 57 e 133. Një zhvillim fonetik *e+i* në *i* vihet re dhe në frengjishten, si te *lectus: *lieit: lit*, Sandfeld IJ XIII f. 389 (V. Thomsen). — Si një zgjerim me *-tore*, *vitore* është një nomen

agentis, i llojit *punëtore, javatore* (sh. dhe Xhuvani-Çabej Prapashtesat 93), kështu që edhe nga ana e formimit kuptimi i fjalës është «ajo që bën vegjë, që ven». Një ndikim i këtyre figurave të besimeve popullore të sotme të Ballkanit nga moirat e mitologjisë greke të vjetër me Klothonë e tyre që do të thotë «tjerrësë», është i mundur, po jo i domosdoshëm. Të tilla figura dalin edhe gjetkë, ndër të tjerë dhe te popujt nordikë (nornat). Ajo që peshon më shumë në këtë mes, është se këto tri figura i kanë pasur edhe mesapët e vjetër të Apulisë jugore (*logetibas*).

Me këtë analizë shihet se përdorimet e tjera të fjalës, qofshin ato të një lloj gjarpëri të shtëpisë, qofshin të një gruaje që lind shumë fëmijë, janë sekundare. Prej shprehjesh të tilla si *të daltë vitorja përpara* «të priftë e mbara» me një përdorim konkret të fjalës, u zhvillua dhe një kuptim abstrakt i saj, «fat», në shprehje si *të tillë vitorë kish*, te Boçari 8 «*τύχη*». Andej dhe kompoziti *vitorezi*, fem. *vitorezezë* «fatzi, fatzezë», që e ka ndër të tjerë edhe fjalori i Boçarit f. 63; në Margëllëç (Paramithi) të Çamërisë në një këngë *Fshatarët vitorezës*.

vq vani m. «luginë». Këtë fjalë te Borgo Erizzos (Arbëneshit) të Dalmacisë Tagliavini 285 nuk e sqaron nga ana e etimologjisë, vetëm se sheh aty një fjalë të ndryshme nga *va vau*, shm. *vana*. Poashtu mendon edhe Jokli (Archivum Romanicum XXIV 40), veçse ky dijetar e afron fjalën përbrenda shqipes me *vang* «rrethi i drunjtë i rrotës, ku mbërthehet rrethi i hekurt; gavelli i rrotës» (sh. këtë fjalë).

Sikundër e kemi shtjelluar dhe në LP VII 166v., kjo fjalë është një me *vā vau*, *va vani*, fjalë që në anët perëndimore të liqenit të Shkodrës ka dhe kuptimin e atyre të hyrave në breg të detit, në të cilat vendohen barkat e lundrat e familjeve detare (khs. për këto Rr. Zojzin, Bul. për Shk. Shoq. 4, 1955, f. 172v.). Nga *vā*-u është formuar m'anë tjetër edhe *vanë* f., sh. këtë fjalë. Për zhvillimet e kuptimit sh. te *vanë*.

vojna shm., në *vojna të mira* «erëra të mira». Këtë fjalë të gazetës Tomori (Nr. 6, 1910, f. 4 sht. 4) Jokli (Studien 116, Slavia XIII 641) e spiegon nga sllavishtja, sllav. e vj. kishtare *vonja* «erë e mirë» serbokr. *vonj, vonja* «erë». Poashtu Selishçevi 193, 305.

Sikundër e kemi shënuar dhe në LP VII 194, *vojna* nuk është tjetër veçse shumësi më *-na* i *voj-it*, toskërisht do të ishte *vajëra të mira*. Për një të tillë përdorim të kësaj fjale khs. *aroma edhe vojna eret* «*ἀρώματα καὶ μύρα*», dhe edhe *le të më qirtojë, se është voj me erë* te Kristoforidhi (Dhiata e re gegnisht 169, Luka 23, 56; Psalmet geg. 141, 5), te ky autor e te Zanoni (Mateu 26, 9. 12) *voj ere*. Khs. dhe lat. *olea* pl. «odores». Në shqipen edhe shumësi i *bar-it* përdoret me një kuptim të këtillë të kozmetikës; Budi SC 58 *ō me lyem faqenë me qishdo barëna qi të duketë ende ma e bukurë*, Bogdani (II 127,7) *votnë me blëm barëna të pāçmueme* «*andarono a comperare preziosi unguenti*».

vrabéc m.: sh. *harabél*.

vrazhdë (i), *vrashhtë* (i) «i ashpër, fjalërendë», *njeri i vrazhdë*, fjalë të *vrazhda*, me të *vrazhdë*; i ashpër në të prekur», *stofë e vrazhdë*; *vrazhdë*, *vrashhtë* «ashpër, me të egër», *më foli vrazhdë*; *vrazhdoj, vrashtoj* «ashpërsoj». Për këtë fjalë G. Meyeri 478 nisat nga një kuptim «trubull, i ngrysur», dhe kështu e afron me *vranët vrërët* e me *vramuz* «njeri i vrërët, i ngrysur». Mendim i pranuar dhe te Jokli (LKU 155), i cili gjen aty një zgjerim të fjalës *vranë* me *-shtë*, duke nxjerrë në dritë dhe trajtën *vrashhtë*. Vasmeri (Studien I 65) e kërkon burimin në sllav. e vj. kishtare *vrazb* «*armiçësor, djallëzor*», ashtu dhe Selishçevi (f. 186, 196) në bullg. *vrazda*

«armiqësor», po kundra këtij spjegimi sillet Jokli në Slavia XIII 610.

Fjalë e burimit dialektor (e gegërishtes), që ka marrë përdorim të përgjithshëm. Nuk del tek autorët e vjetër të Veriut, prandaj ka të ngjarë që në atë trajtë që ka, të jetë një fjalë relativisht e re. Pranë *i vrashtë* ka *i vrashtëm*: Junku e Bashkimi «aspro, pungente, malinconico, triste, mordace», Gazulli 1. qi vret, *bukë e vrashtë* «e thekët», *fjalë e vrashtë* «e ashpër, e egër», 2. i mrrolët, *fëtyr'e vrashtë*, it. burbero, lat. severus». Nga këto të dhëna shihet se *i vrashtë* është «ai që vret, që godit me fjalë». Prandaj fjala është një zgjerim me *-shtë* i *vras*, i pjesores geg. *vra*. Për këtë sufiks në mbiemra sh. Xhuvani-Çabej, Prapashtesat 88. Ndërkaq te kuptimi «i mrrolët, i ngrysët» mund të ketë ndikuar dhe *vranët*. Sonorizimi i konsonanteve në rrokje fundore te *vrazhdë* është shpeshtë, khs. *prazhdë* *prashtë*.

vrej «vë re, vështroj me kujdes; shënoj», *vrehet* «vihet re.» G. Meyeri (f. 243 te *lëndi*, 362 te *re* 1) jep për këtë fjalë variantet *vërenj vrenj vërrënj rrenj*, kal. sic. *varënj* shkodr. *vuroj* etj., dhe e spjegon atë me të drejtë nga *vë re*. Pa të drejtë Kamarda (I 145) e krahasonte drejtpërdrejt me gr. ὄραω «shoh».

Ashtu si *bzâj*, *ngarënd* e ndonjë tjetër, kjo është një nga ato folje që kanë dalë nga univërbimi i lidhjes folje + emër, folje «delokutive» në kuptimin e E. Benvenistit. Në një vështrim më të gjerë janë fjalë formuar në ngërthim të fjalisë, si *druese*, *shklata* etj. Është një fjalë dialektore e përgjithësuar. Nga arbërishtja e Italisë e dëshmon dhe Giordano 551 për të folët e Frasnitit të Kalabrisë. Sh. edhe vrejjet tona SA II 1 19.

R é s u m é

ETUDES D'ETYMOLOGIE ALBANAISE XXV

vā m., n., f. «gué». Plutôt qu'un emprunt du lat. vadum (G. Meyer et d'autres savants), pour des raisons phonétiques ce nom est un mot hérité (L. Spitzer, N. Jokl).

vag-a f. «romaine» vagir m. «petite balance; palonnier». Mot dialectal, de l'all. Wage, anc. haut ail. wâg, à travers le serbo-cr. vaga, vagati.

vagëllój «cligner (les yeux)», vagullon «le jour vient à poindre». Comme a été remarqué par G. Meyer, le même mot que agon «il fait jour» agim «aube», une connexion avec le gr. ἀχλύς «obscurité, ténèbres, brouillard» (St. E. Mann) étant loin de toute manière.

vagjëli f. «bons soins, cures», vagjiléps «soigner». Mot dialectal, du néo-gr. βαΐας «serviteur» βαιλίζω «servir» βαιλεύω «caresser un enfant», pénétré aussi en bulgare.

vajë f. «nourrice». Mot régional, provenant du grec (moderne ou médiéval) βάγια, βαια, remontant à son tour au lat. baiulus, et passé aussi en bulgare.

Vajkál m., nom d'une vallée de passage dans la région de Dibra, chez M. Barletius (1537) et les albanais de Sicile Valkál. Plutôt du roum. val(e) cale que du lat. val(lis) callis «vallée - passage».

vajzë f. «jeune fille; fille; vierge», aussi varzë, vashë, vashëzë, etc. Ni du groupe anc. ind. vârdhati «il croît, il augmente», vieux sl. rodъ

«naissance, race; fruit», etc. (Treimer), ni de celui du lat. *virgo* ou du gr. **παρθένος** (Barić), ni le reflet d'un **suoró* »la propre» appartenant à *sue-*, *suo-* (Jokl), le mot désignant la jeune fille, non pas la propre fille (*filia*).
 Forme de base — comme a été déjà établi — *var-*, identique au fond à *varrë* «plaie, raie, rayure», *vara-vara* «rayé» (dit d'une étoffe). Dénomination de la fille comme «fente, fissure», d'après son organe génital, par voie d'une synecdoque. Cfr. le port. *ca(i)xopa* «jeune fille», sens propre «*cunnius*».

vakër «brebis ou mouton au visage et aux extrémités des jambes noires». Ramené par Candrea au roum. *oacâr* «mouton aux taches noires au visage», ce mot dialectal remonte plutôt à l'aroumain.

val m., probablement «vallée», dans des expressions comme *mal e val* «montagne et vallée», et dans maints toponymes du pays. Un des éléments latins de l'albanais conservés surtout dans la toponymie.

valanicë f. «moulin à foulon, foulerie». Emprunt slave, entrevu déjà par Kristoforidhi. De provenance serbo-croate au nord, bulgare à l'est du pays.

valë f. «onde, flot, vague; bouillonnement», *valoj* «bouillonner, bouillir», *përvëloj* «faire bouillir; bouillir, être ardent», *suvalë* «flot, vague». Comme on sait, du groupe anc. haut all. *wëlla* «onde», lit. *vilnis* «onde», etc. L'a du mot albanais représente ou un l syllabique (Brugmann) ou un o originaire (G. Meyer, La Piana).

valikë f. «temps opportun pour les travaux des champs». Formation de *valë* «onde, flot, vague; bouillonnement», employé dans un sens métaphorique.

vanderë f.: v. *panderë*.

vanë f. «rainure, enrayure», *vana e pusit* «cercle supérieur d'un puits». Le même mot que *vana-t*, le pluriel de *vã* «gué» employé aussi au singulier, où rentre, en outre, *vo vani* «vallée». Changements de sens, de «gué» à «sinuosité», «canal», «vallée», comme dans les reflets romans des lat. *canalis e vallis*.

vang vëng m. «jante d'une roue; rayon d'une roue, rai», *vangu i opangës* «lacets des sandales dites *opanga*». Rattaché, depuis G. Meyer, ensemble avec *i vëngër*, *i vangët*, *vangósh* «louche, strabique», au groupe de lit. *vëngiu* «éviter» *vingis* «arc, courbure» *vingùs* «courbé», let. *wanga* «anse d'un vase», anc. haut all. *winchil* «angle, coin», etc. L'alternance a : ë indique un mot ancien de l'albanais. Sens métaphorique dans *vang* «prétexte».

vardüe m. «verdier». Emprunt italien, de *verdone* même sens (Helbig).

vargër vërgâ m. «mouton ou bouc non châtré, étalon», aussi *vërgâr*, *vergâr*. Ni du roum. *vargã* «verge», ni d'un lat. *virgarius* ou **virganus* (G. Stier, G. Meyer). Identique à **βάρχοι ἄρνες Λάκωνες** de Hésyche, mot dorien provenant, à notre avis, d'une phase antérieure de l'albanais.

varkë f.: v. *barkë*.

varósh m. «quartier d'une ville, située hors des murs d'enceinte, quartier chrétien». La question si ce mot hongrois (*varosz* «ville») est pénétré en albanais à travers le turc (G. Meyer) ou par voie du serbo-croate, dans une époque antérieure (Jokl), reste ouverte.

vec m.: v. *kastravéc*.

verzë, vercë f., plus souvent au pluriel *verza*, *verca* «branchies, ouïes». Ni du serbo-cr. *brk* «moustache» (G. Meyer), ni d'un lat. **vertia* formé de

vertère «tourner» (Jokl), mais, ensemble avec verca-t pl. «versoir», un dérivé de vesh «oreille».

vezullón «étinceler, briller, éclater», vezullojë f. «luciole», vezullim m. «étincellement, éclat». Aucun rapport avec vetëtij «rendre luisant, polir» vetëtin «il fait des éclairs» ou le sl. svëtiti «luire, briller» (G. Meyer). A rapprocher de dhezëllima «étincelle» de Gj. Buzuku, et, avec ce nom, à dhez, ndez «allumer». Alternance dh : v, assez fréquente en albanais.

vërshëllëj: v. fërshëllëj.

vërshój «déborder», dit des rivières; dépasser les bords, excéder», dans P. Budi u vershuo «déborda». Non pas du lat. versare (G. Meyer, S. Puşcariu), mais au fond le même mot que lëshoj «lâcher», lëshohem «se jeter», dans F. Bardhi Me lëshuem ujëtë «restagnare». Remplacement de la syllabe lë- par le préfixe vër-.

vërrí f. «petit sillon, raie, strie». Ni le proche parent de vërë vrimë ou birë «trou» (G. Meyer), ni du groupe de lat. versus «sillon; ligne» verso «traîner, balayer» vieux norr. vorr «coup de rame» (Jokl). Dérivation en -í de varrë «plaie; raie, rayure», vara-vara «rayé» (dit d'une étoffe), forme à métathèse rruví «ligne, raie». Ici rentrent encore vurratë, et vrragë «ornière; impression profonde».

vgjollë f.: v. gjollë.

vigje-t fpl. «cadeaux consistant en des comestibles, à l'occasion d'une naissance ou de la construction d'une nouvelle maison». Resté sans étymologie chez G. Meyer, ramené par Jokl à une forme de base à -gl- (*ved-l-), et rattaché, comme tel, au groupe gr. ἔδνον «prix de la fiancée versé par le mari» anc. haut all. widomo «dot» vieux sl. veno «dot», ce nom représente le pluriel de vig «passerelle, poutre placée sur un cours d'eau; arbre de la charrue; brancard, civière, cercueil». Une synecdoque, le contenant pour le contenu. Cfr. à ce propos le gr. moderne $\kappa\alpha\upsilon\sigma\iota\kappa\iota$ «don, présent»: $\kappa\alpha\upsilon\sigma\iota\sigma\tau\omicron\nu$ «corbeille, panier», le frç. corbeille de mariage, etc.

vigjöz f., «vesce». Du lat. vicia, emprunt resté inaperçu jusque-là.

visár vistár m. «trésor». Pas de rapport avec vështroj «faire attention, observer, examiner, regarder; prendre soin de, élever». Ensemble avec le roum. vistier «cassette; trésorier», du gr. byzantin βιστάριον, βιστιάριον, βεστιάριος, ce mot même du lat. médiéval vestiarius «garderobier».

vishkëllój: v. fishkëllój.

vishtat (të) fpl. «les blés, les récoltes». Apparenté, comme l'a bien établi N. Jokl, à vjeshtë «automne» et visharak «fertile». Moins sûre l'appartenance de vesh (rrush) «pièce d'une grappe de raisin, petite grappe».

vitërk m. «beau-père, mari de la mère qui a des enfants d'un autre lit.» Du lat. vitricus même sens (C. Tagliavini). Concordance de l'albanais avec le roumain, le sarde et les parlers italiens du sud. Une origine roumaine n'est pas exclue.

vitore f. «figure des croyances populaires, qu'on se figure sous la forme d'un serpent aux cornes dorées et qui pond de l'or, ou comme un serpent court et gros qui veille à la maison; femme qui a mis au monde beaucoup d'enfants; une des trois fées qui, dans la troisième nuit après la naissance d'un enfant, le visitent et déterminent sa destinée». Ni, en qualité de «vieille femme», apparenté à vit vjet «an, année» (Hahn, Stier, G. Meyer, Lambertz, Marlekaj), ni, comme «esprit familier», le proche parent du lit. vêtà let. witta «lieu, endroit» (Treimer), ni du lat. victoria

(Xylander). Représente un vejtoare «tisseuse», dérivé de vegj «métier», ou bien de vej «tisser». A la base de ce nom est la croyance que les trois fées tissent ou filent la trame de la vie des hommes. Même idée dans roum. ursite ursitoare urzitoare: urzi, du lat. ordire, serbo-cr. suéije: suçi sukati «filer», le gr. Klōtho, le messap. logetibas, etc. La réduction de la diphthongue ej en i est fréquente en albanais. Dans quelque parlars, vitore a abouti au sens de «destinée» ou «bonheur».

vq vani m. «vallée», mot de l'albanais de Dalmatie. Même mot que vā vau, vā vani «gué», malgré l'opposition de M. Tagliavini et de Jokl. Pour le développement de sens cfr. vanë, ci-dessus traité.

vojna pl., dans vojna të mira «aromates, parfums». Non pas du sl. vonja «odeur» (Jokl, Seliščev), mais bien au contraire le pluriel vojna, de voj «huile», au sens de lat. olea «odores». Dans ce même sens est employé bar «herbe; médecine».

vrabéc m.: v. harabél.

vrazhdë (i), vrashtë (i) «dur, âpre, rude», vrazhdë, vrashtë «durement, âprement, rudement», vrazhdój, vrashtëój «rendre dur, âpre, rude». Ni apparenté, à l'intérieur de la langue, à vranët vrërët «couvert de nuages, nuageux, troublé» (G. Meyer, Jokl), ni un emprunt du slave, vieux sl. vrazb «hostile, diabolique» (Vasmer, Seliščev). En raison aussi de la forme i vrashëm, ce mot résulte être un postverbal en -shtë të vras (participe vrā) «tuer, blesser, faire mal, endommager». Sonorisation de la sifflante en syllabe finale. Une influence de vranët quant au sens de «morne, sombre» de vrazhdë, est pourtant bien possible.

vrej «regarder, observer, «remarquer», mot aussi de l'albanais d'Italie. Comme l'a bien constaté G. Meyer, une lexicalisation de vë re même sens. Mot dialectal généralisé, vrej est tout aussi un verbe «délocutif» au sens de E. Benveniste, comme bzâj «appeler» et ngarënd «courir».